



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 13
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 28 mars 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Flora Brovina, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Miljana Nikoliq, Faton Topalli, Naser Rugova dhe Bekim Haxhiu.

Pjesëmarrës të tjerë: Ervin Ibrahim, Nora Sahatçiu dhe Shpend Qamili, UNKT, Egzon Osmanaj, KDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresë Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

RENDI DITËS:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.3.2018;**
3. **Takim me kryeshefin e Agjencisë për Produkte dhe Pajisje Medicinale;**
4. **Shqyrtimi i raportit të performancës për Efikasitetin dhe Efektivitetin në Implementimin e Sistemit Informativ Unik të Integruar Shëndetësor;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

Pika 3. Takim me kryeshefin e Agjencisë për Produkte dhe Pajisje Medicinale është shtyrë për njërin nga mbledhjet e radhës se komisionit, pasi që kryeshefi i AKPPM-së ka paralajmëruar se nuk do të mund të marrë pjesë në këtë mbledhje, për shkak objektiv.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 7.3.2018;

Komisioni miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes të mbajtur më 7.3.2018.

3. Shqyrtimi i raportit të performancës për Efikasitetin dhe Efektivitetin në Implementimin e Sistemit Informativ unik të Integruar Shëndetësor;

Besa Baftiu, kryetare e Komisionit: Në shkurt të vitit 2017, Kuvendi ka miratuar Rezolutën, e cila e obligon Zyrën Kombëtare të Auditimit, të bëjë auditimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor –SISH, prej fillimit të tij e deri në fund të vitit 2016. Po ashtu, është kërkuar që të përgatisë raport me shkrim për Kuvendin. Ne e kemi pranuar raportin e auditorit, i cili ka bërë auditimin e SISH-it. Dhe në bazë të Rezolutës, ministri i MSH-së ka qenë i obliguar që në Kuvend të raportojë në baza të rregullta tremujore për funksionalizimin e SISH-it dhe tash ne jemi në mars të vitit 2018, ndërkohë që ministri i MSH-së s'ka raportuar para Kuvendit.

Në bazë të gjeturave të raportit të auditorit për SISH-in, shihet se ka pasur keqpërdorim apo keqmenaxhim të buxhetit të SISH-it. Pra, të gjithë e dimë se SISH-i është parakusht për implementimin e sigurimeve shëndetësore. Sipas raportit del se mjetet nuk janë shpenzuar të gjitha për implementimin e SISH-it, mirëpo, janë shfrytëzuar për çështje të tjera. Pra, 76% e pagesave janë realizuar për aktivitetet e ndërlidhura me SISH-in, ndërsa 24% të pagesave, që në vlerë financiare është 417 mijë euro, janë realizuar për projekte të tjera, të cilat nuk ishin paraparë me projektin e SISH-it. Për më shumë, nga buxheti i SISH-it janë kryer pagesat për: vendime gjyqësore në vlerë prej 201 mijë euro, 77 mijë euro për furnizim me Rëntgen në QKUK, 59 mijë euro për furnizim me “Digital ultrasound imaging system”, 70 mijë euro për “përpilim i termave të referencës, projektit ideor dhe renovim dhe sanim i ashensorëve në QKUK” dhe 9 mijë euro, për “integrimin e bazës së të dhënave në portalin e E-Qeverisjes”. Mosimplementimi i SISH-it, del se ka qenë si pasojë e mosmenaxhimit të mirë nga MSH-ja dhe ne ende nuk e kemi një raport të detajuar se pse ka dështuar funksionalizimi i këtij sistemi.

Komisioni, diskutoi për raportin e auditorit për Sistemin e Informimit Shëndetësor –SISH, dhe shprehu shqetësimet për keqmenaxhimin dhe vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi, i cili konsiderohet si parakusht për fillimin e funksionimit të sigurimeve shëndetësore. Po ashtu, shfrytëzimi i buxhetit për projektin e SISH-it për pagesa të projekteve tjera, ka qenë një keqmenaxhim i buxhetit. Dhe në këtë rast duhet të ftohet ministri i MSH-së që të raportojë për planet dhe hapat konkret se çka është duke bërë MSH-ja me SISH-in.

Pas diskutimeve për raportin e SISH-it, komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- Të ftojë ministrin e MSH-së, që të raportojë para Komisionit, për:

Adresimin e rekomandimeve të raportit të auditorit për projektin e SISH-it, apo raportin e performancës për Efikasitetin dhe Efektivitetin në Implementimin e Sistemit Informativ Unik të Integruar Shëndetësor;

Procesin e revidimit të listës esenciale të barnave.

4. Të ndryshme.

Besa Baftiu, kryetare: Projektligji për gjak dhe përbërës të gjakut, ka kaluar në lexim të parë, andaj ne si komision duhet të fillojmë me amendamentimin e tij. Ne si komision po e themelojmë grupin e punës, i cili do të shqyrtojë dhe pastaj të përgatisë raportin më shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

Pas diskutimeve që u zhvilluan në lidhje me propozimin për grupin punues, Komisioni nxori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Grupi i Pnuës për shqyrtimin e projektligjit Nr. 06/L-042, për gjak dhe përbërës të gjakut.
2. Grupi punues ka këtë përbërje:
 - 2.1. Fatmire Kollqaku, Mulhaxha, kryesuese
 - 2.2. Besa Baftiu, anëtare.
 - 2.3. Haxhi Avdyli, - anëtar
 - 2.4. Time Kadrijaj, anëtare

Besa Baftiu, kryetare, e njoftoi Komisionin se deputeti Faton Topalli nuk do të jetë deputet i këtij komisioni dhe se duhet zëvendësuar kryesuesin e grupit punues për amendamentimin e Projektligjit për Ndërmarrjet Sociale, të cilin e ka kryesuar deri me tani deputeti Topalli

Komisioni, vendosi që në vend të deputetit Faton Topalli, kryesuese e grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Ndërmarrjet Sociale të jetë deputetja Flora Brovina.

Enver Hoti, njoftoi komisionin për takimin që kanë realizuar të gjithë kryetaret e komisioneve me Kryetarin Kuvendit dhe ku është kërkuar nga komisionet që të përshpejtohen procedurat për shqyrtimin e projektligjeve që kanë ndërlidhje me agjendën e reformës evropiane –ERA. Po ashtu është kërkuar që të rritet intensiteti i punës së komisioneve në shqyrtimin e projektligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU